

Qendra urgjente të strehimit në rast të lirimit nga burgu gjatë COVID-19

Ky dokument përcakton qendrat urgjente kryesore për strehim në Gjenevë gjatë epidemisë COVID-19, të cilat janë në dispozicion veçanërisht për të burgosurit e liruar dhe të pastrehë.

Ky dokument nuk është shterues apo definitiv. Informatat mund të ndryshojnë në varësi të zhvillimit të situatës.

*Rekomandohet që për opsionet në dispozicion të informoheni falas në numrin e telefonit **0800 447 700** i vënë në dispozicion nga qyteti i Gjenevës (« Ville de Genève ») për raste urgjente sociale, çdo ditë prej orës 9:00 deri në orën 17:00,.*

A) Qendra kryesore gjatë natës

1) Kazerma ushtarake në Vernets (« La Caserne des Vernets »)

Kazerma ushtarake në Vernets mirëpret të gjithë personat të pastrehë (zvicëranë ose të huaj) pas lirimit nga burgu që t'i strehojë ata për disa netë, **në varësi të disponueshmërisë.**

Nëse kërkon strehim në kazermën ushtarake në Vernets, ju duhet të paraqiteni në hyrje të kazermës çdo ditë prej orës 14:00 deri në orën 16:00. Kazerma nuk pranon **asnjë person të ri pas orës 16:00.**

Kazerma ushtarake në Vernets ndodhet në rrugën Hans Wilsdorf, 1, 1227 Carouge (në mes të lagjës Plainpalais dhe Les Accacias, përballë patinazhit dhe pishinës së Vernets).

Për të arritur në Kazermën ushtarake në Vernets prej burgut Champ-Dollon, ju mund t'a merrni autobusin e mëposhtëm (me një biletë të vlefshme):

- autobusin me numër 34 në drejtim të Veyrier, zbritni në Stacionin e autobusit Montagne;
- autobusin me numër 9 në drejtim të Lignon, zbritni në Stacionin e autobusit Délices;
- autobusin me numër 11 në drejtim të Bout-du-Monde, zbritni në Stacionin e autobusit Vernets.

2) Qendra tjera të strehimit

Qendra tjera të strehimit janë të planifikuara, veçanërisht për njerëzit në nevojë ose të semurë, në varësi të disponueshmërisë.

Rekomandohet që të informoheni në numrin 0800 447 700 (çdo ditë prej orës 9:00 deri në orën 17:00).

B) Qendra që shërbejnë ushqim falas gjatë periudhës COVID-19

Vendet e mëposhtëm gjenden pranë kazermës ushtarake në Vernets dhe janë të arritshme në këmbë:

- Mëngjes dhe drekë falas :
 - Club Social Rive Gauche: Rruga Hugo-De-Senger 4, 1205 Genève (tel : 022 418 98 50)
 - Mëngjes për të marrë me vete prej të hënës deri të premten prej orës 7:30 deri në orën 8:30;
 - Ushqim të nxehtë për të marrë me vete prej të hënës deri të premten në orën 11:00, 12:00 dhe 13:00 (ju lutem vini re: një biletë duhet të merret prej orës 10:30) ;
 - Ushqim të nxehtë për të marrë me vete të shtunën në ora 11:00;
 - Ushqim të nxehtë për të marrë me vete të dieleve dhe ditë festë në orën 11:00, 12:00 dhe 13:00 (ju lutem vini re: një biletë duhet të merret prej orës 10:30);
 - Le Carré: Rruga Grand-Bureau 13, 1227 Les Accacias (tel : 022 343 17 17)
 - Ushqim të nxehtë për të marrë me vete prej të hënës deri të premten nga ora 11:00, deri sa ka rezerva në dispozicion (më së voni deri në orën 14:00)

- Bateau Genève : Quai Gustave Ador 1, 1207 Genève
 - Mëngjes për të marrë me vete prej të hënës deri të premtën nga ora 7:30 deri në orën 9:00;
 - Ushqim të nxehtë për të marrë me vete prej të hënës deri të premtën në orën 13:00;
 - Ushqim të nxehtë për të marrë me vete të dielën në orën 17:30 ;

 - Le Phar : Rruga Jean-Jacques de-Sellon 3, 1201 Genève
 - Ushqim të nxehtë për të marrë me vete të hënën, të mërkurën dhe të premtën deri në orën 11:30, deri sa ka rezerva në dispozicion (më së voni deri në orën 13:30) ;
- Darkë: shërbehet në kazermën ushtarake në Vernets.

Ju lutem vini re: vendet dhe oraret mund të ndryshojnë.

Ekzistojnë edhe vende të tjera që shërbejnë ushqim falas.

Rekomandohet që të informoheni rregullisht në mënyrë që të njoftoheni me opsionet në dispozicion.

C) Kthimi i sendeve të sekuestruara

Nëse bëhet pushimi i sekuestrimit të sendeve të marra, personat e liruar mund të kërkojnë t'u kthehen sendet e tyre, me kusht që ata të kenë një autorizim të lëshuar nga Prokuroria Publike.

Rekomandohet të kontaktoni Regjistrin e Provave (« Greffe des pièces à conviction ») për të vendosur modalitetet e kthimit të sendeve.

Regjistri i Provave mund të kontaktohet:

- Me email në : gpc@justice.ge.ch

- Me telefon në numrin : 022 327 60 75 (prej të hënës deri të premtën prej orës 8:00 deri në orën 9:00 dhe prej orës 13:00 deri në orën 14:00).

Ju lutem vini re : Regjistri i Provave është mbyllur gjatë epidemisë COVID-19.
